REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. _____prot., Tiranë ___.___.2026

V E N D I M

Nr. 29, datë 06.11.2026

PËR

MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË PROJETRREGULLORES "PËR CAKTIMIN DHE PËRDORIMIN E BURIMEVE TË NUMERACIONIT"

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	**Gentian Sala**	**Kryetar**
Znj.	**Edlira Dvorani**	**Anëtar**
Z.	**Armer Juka**	**Anëtar**
Z.	**Bleron Dokle**	**Anëtar**
Znj.	**Diana Dervishi**	**Anëtar**

dhe sekretare znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 06 nëntor 2026, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" dhe Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)" miratuar me vendimin nr.11, datë 31.03.2026, të Këshillit Drejtues të AKEP me propozim të Drejtorisë së Administrimit dhe Menaxhimit të Burimeve të Fundme, shqyrtoi çështjen me objekt si më poshtë:

- Miratimin për këshillim publik të projektrregullores "Për caktimin dhe përdorimin e burimeve të numeracionit".

BAZA LIGJORE:

1. Pika 4 e nenit 132 të ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë";
2. Rregullore "Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik", miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 21, datë 07.12.2021.

KËSHILLI DREJTUES I AKEP

Pasi shqyrtoi materialin shkresor, të përbërë nga:

1. Dokumenti për këshillim publik, projektrregullore "Për caktimin dhe përdorimin e burimeve të numeracionit";
2. Relacioni shoqërues i projektvendimit;
3. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar

V Ë R E N:

1. Ligji nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", përcakton kuadrin ligjor për rregullimin e sektorit të komunikimeve elektronike dhe kompetencat e AKEP-it në administrimin e burimeve të komunikimeve elektronike, përfshirë burimet e numeracionit.

2. Në zbatim të neneve 131 deri në 136 të ligjit nr. 54/2024, AKEP, ka kompetencën dhe detyrimin të përcaktojë rregullat për administrimin, caktimin dhe përdorimin e burimeve të numeracionit, si dhe për hartimin, miratimin, zbatimin e Planit Kombëtar të Numeracionit.

3. Projektrregullorja "Për caktimin dhe përdorimin e burimeve të numeracionit" është hartuar në zbatim të dispozitave të sipërcituara të ligjit nr. 54/2024, duke marrë në konsideratë gjithashtu përcaktimet e neneve 26, 28 dhe 32 të këtij ligji, lidhur me autorizimin e përgjithshëm dhe ushtrimin e veprimtarisë nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

4. Projektrregullorja është hartuar bazuar në dokumentacionet si më poshtë:

   - Rekomandimin ITU-T E.164 (Planin e Numeracionit për shërbimet e telefonisë),
   - Rekomandimin ITU-T E.212 (Planin e Identifikimit për rrjetet dhe shërbimet publike të lëvizshme),
   - Rekomandimin ITU-T Q.708 (Kodet e Pikave të Sinjalizimeve Ndërkombëtare (ISPC) dhe Kodet e Pikave të Sinjalizimeve Kombëtare (NSPC),
   - Rekomandimin ITU-T E.118 Kodet IIN (Issues Identifiers Number),
   - Plani i Numeracionit për shërbimet e mesazheve të shkurtra me vlerë të shtuar (SMS VAS
   - Udhëzimin e BEREC BoR (20) 50, datë 6 mars 2020, "Mbi kriteret e përbashkëta për vlerësimin e aftësisë së sipërmarrjeve të ndryshme nga ofruesit e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike për administrimin e burimeve të numeracionit dhe të rrezikut të shterimit të tyre".

- Udhëzimet e BEREC BoR (20) 50, datë 6 mars 2020, "Mbi kriteret e përbashkëta për vlerësimin e aftësisë së sipërmarrjeve të ndryshme nga ofruesit e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike për administrimin e burimeve të numeracionit dhe të rrezikut të shterimit të tyre.

5. Projektrregullorja synon të krijojë një kuadër të qartë dhe të përditësuar për administrimin e burimeve të numeracionit, duke përcaktuar strukturën, gjatësinë dhe mënyrën e përdorimit të tyre, si dhe procedurat për aplikimin, caktimin, ndryshimin, transferimin, pezullimin dhe revokimin e të drejtave të përdorimit të numrave dhe serive numerike. Gjithashtu, ajo përcakton të drejtat dhe detyrimet e mbajtësve të këtyre të drejtave, si dhe përgjegjësitë e AKEP-it në administrimin dhe mbikëqyrjen e tyre.

6. Projektrregullorja është e strukturuar në 5 kapituj, 47 nene dhe 5 Shtojca. Përfshin rregullat për administrimin e burimeve të numeracionit, Planin Kombëtar të Numeracionit, numrat gjeografikë dhe jogjeografikë, kodet e aksesit dhe kodet e shkurtër, numrat e emergjencës dhe numrat për shërbimet me interes publik, si dhe planet e tjera numerike dhe kodet identifikuese, përfshirë NSPC, ISPC, MCC/MNC dhe IIN.

7. Përcaktimi i procedurave transparente, objektive, proporcionale dhe jodiskriminuese për caktimin dhe përdorimin e burimeve të numeracionit synon të garantojë administrimin efikas të këtyre burimeve të kufizuara, përdorimin e tyre racional dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë caktuar, si dhe rritjen e transparencës për disponueshmërinë dhe përdorimin e tyre.

8. Projektrregullorja synon gjithashtu të mbështesë funksionimin e qëndrueshëm dhe ndërveprues të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe aksesin e përdoruesve fundorë në shërbimet e emergjencës dhe shërbimet e harmonizuara me interes social.

9. Bazuar në nenet 44 dhe 45 të ligjit nr. 54/2024 dhe në Rregulloren "Për procedurat e këshillimit publik", miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, nr. 21, datë 07.12.2021, dokumenti i miratuar nëpërmjet këtij vendimi do të bëhet objekt i këshillimit publik, me qëllim marrjen e mendimeve, komenteve dhe sugjerimeve nga sipërmarrësit, përdoruesit dhe palët e tjera të interesuara,

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë për këshillim publik Projektrregulloren "Për caktimin dhe përdorimin e burimeve të numeracionit" sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Procedura e konsultimit publik, të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit sipas pikës 3 të këtij vendimi.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti për konsultim publik: Projektrregullore "Për caktimin dhe përdorimin e burimeve të numeracionit" të publikohen në faqen zyrtare të AKEP, www.akep.al.
4. Ngarkohet adminitrata e AKEP, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	**Edlira Dvorani**	**Armer Juka**	**Bleron Dokle**	**Diana Dervishi**